



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:265434

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05641627

Ac.nr.2258/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj, kryetar i kolegjit, Malsor Kryeziu dhe Bujar Muzaqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëseve L. M. S. dhe L. H. të punësuar në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët “I. M.” në Malishevë, të cilët me autorizim i përfaqëson Av. Z. H. nga Prishtina, ndaj të paditurës Komuna e Malishevës, Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati publik komunal M. S., për kompensimin e shujtës ditore, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Dega në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1083/2021, të datës 19.01.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 29.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Malishevës Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA), ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Dega në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1083/2021, i datës 19.01.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, .nr.1083/2021, i datës 19.01.2023 ka vendosur si në vijim: “I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësve L. M. S. dhe L. H. të punësuar në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët “I. M.” në Malishevë si e bazuar. II. DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit. që në emër të kompensimit të shujtave për ditët në punë, t’ua paguaj paditësve në vijim: Paditësit L. M. – S. për 115 ditë të punës për periudhën nga data 01.01.2021 deri 04.10.2021 të përlllogaritur sipas shumës nga 2 euro në ditë t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej në 230.00 euro, dhe Paditësit L. H. për 115 ditë të punës për periudhën nga data 01.01.2021 deri më 04.10.2021 të përlllogaritur sipas shumës nga 2 euro në ditë t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej në 230.00 euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%

që nga dita e paraqitjes së padisë dt. 11.11.2021, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm. III. DETYROHET e paditura që paditësve t'ua kompensojë shpenzimet e procedurës paditësve dhe atë në emër të parashtrimit të padisë në shumën prej 208.00 euro dhe në emër të taksës shumën prej 20.00 euro, në shumën e përgjithshme prej 228.00 euro. “

Kundër këtij aktgjykimi e paditura brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta refuzojë si të pabazuar apo çështjen t'ia gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Nga shkresat e lëndës nuk mund të gjendet se paditëset kanë parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- *Ankesa e të paditurës është e pabazuar.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditëset L. M. S. dhe L. H., përmes të autorizuarit të tyre, me datë 11.11.2021, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi të cilën e kanë precizuar përmes parashtrësës së datës 01.11.2022 për kompensimin e shujtës ditore, kundër të paditurës, me pretendimet se të njëjtat janë në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura si mësimdhënëse në SHFMU “I. M.” në Malishevë dhe se të njëjtave në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit u takon kompensimi për ushqim për ditët e pranisë në punë (me detaje të tjera sikur në padi). Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëseve, pas shqyrtimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar (*pa shqyrtim kryesor të çështjes*) C.nr.1083/2021, të datës 19.01.2023, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëseve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se në bazë të provave të dhe përgjigjes së dhënë në padi nga e paditura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura në punë dhe detyra të punës mësimdhënëse në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “I. M.” në Malishevë, po ashtu nuk është kontestuese edhe drejta e kompensimit të mjeteve në emër të shujtave ditore, për periudhën përkatësisht ditët si në dispozitiv këtij Aktgjykimi, gjë për cilën e paditura e ka pohuar këtë të drejtë të tyre, andaj nga provat e administruara, si dhe konform dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021 e lidhur në mes Ministrisë së Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë së Republikës

së Kosovës dhe SBASHK, kjo gjykatë vlerëson se paditëseve i takon e drejta e kompensimit për shujtë ditore gjatë punës për ditët e pranisë në punë përkatësisht për periudhën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit 35, paragraf 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e në lidhmëri me nenin 8, paragrafi 1 të LPK-së dhe 245, paragrafi 1 të LMD-së, Për shpenzimet e procedurës i është referuar dispozitave ligjore nga neni 452, paragrafi 1 të LPK-së. Po ashtu lidhur me vendosjen jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 dhe 398 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore ngase sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike, nuk është kontestues fakti se paditëset për periudhën kohore të specifikuar si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar kanë qenë në vendin e punës. Po ashtu nuk janë kontestuese ditët e pranisë së paditëseve në punë për të cilën periudhë kohore kërkojnë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, shujtës ngase paditësja L. M. S. është në marrëdhënie pune në SHFMU "I. M." në Malishevë dhe për periudhën prej 01.01.2021 e deri më datë 04.10.2021 ka gjithsej 115 ditë punë gjë që provohet përmes Vërtetimit me nr. reference 2997/2021 të datës 04.10.2021. Paditësja L. H. M. është në marrëdhënie pune në SHFMU "I. M." në Malishevë dhe për periudhën prej 01.01.2021 deri më datë 04.10.2021 ka gjithsej 115 ditë pune dhe kjo provohet përmes Vërtetimit me nr. reference 297/2021, të datës 04.10.2021

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: "Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve". Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: "Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe

c) nivel të ndërmarrjes“. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: “ Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”. Me paragrafin 5 përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke e detyruar të paditurën që paditësit t’i paguaj në emër të ushqimit për ditët e kaluara në punë, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021 dhe se e njëjta është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës. Me nenin 35 paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021 përcaktohet se: “Të punësuarve, (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditë e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy €) Euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensim për ushqim”. Me nenin 45 paragraf 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: “MASH, SBASHK dhe Ministria e Financave, angazhohen bashkërisht për t’i informuar dhe ndihmuar komunat, këshillat drejtuese të universiteteve dhe drejtoritë e shtëpive të studentëve që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35. paragrafët 5, 7 dhe 11 kur të krijohen mundësitë financiare në buxhetin e Republikës së Kosovës, por jo më vonë se viti 2023“.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditëses në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: “*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*”.

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën për arsye se e njëjta nuk është nënshkruese e saj, mirëpo këto pretendime Gjykata e Apelit i vlerëson si të paqëndrueshme pasi që referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, përfshirë të drejtën për kompensim të ushqimit, i takon pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë Komuna e Malishevës, Drejtoria Komunale e Arsimit dhe e njëjta ka qenë në fuqi për periudhën të cilën paditëset kërkojnë kompensimin. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj kontrate nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësit, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë, ndërsa në nenin 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021 ndër të tjera thuhet se: “*Dispozitat e kësaj Kontrate*

Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat - DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës...”, ndaj detyrimi për zbatimin e kësaj kontrate ka fuqinë ligjore.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar dispozitën e nenit 152 të LPK-së i cili shprehimisht përcakton “*Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij*”. Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur ka gjykuar këtë çështje kontestimore pa shqyrtim kryesor të çështjes pasi janë plotësuar kushtet ligjore në rastin konkret.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

Ac.nr.2258/2023, më datë 29.04.2024.

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Besnik Bislímaj